



## **Kriteret për mbështetjen e projekteve të vogla në kuadër të bashkëpunimit teknik**

### **Qëllimi i mbështetjes:**

- Ndhimë fleksibël, e shpejtë dhe efektive
- Marrja parasysh e nevojave themelore të shtresave të varfra dhe më të varfra të popullsisë

### **Projekte që mund të mbështeten janë ata, të cilët**

- nuk mund të financohen nga përfaqësues vendas (p.sh. OJF, grupe bamirësie, institucione lokale, institucione fetare etj),
- marrin parasysh shërbime që do të kryhen nga vetë përfaqësuesi, bashkëpunim nga ana e komunitetit dhe rezultatat të qëndrueshëm,
- kërkojnë një ndihmë financiare deri në 8.000 euro, në raste të mirëjustifikuara mundësohet ndihmë financiare deri në 13.000 euro,
- parashikojnë në llogaritjet e tyre blerjen e materialeve në vendin partner ose në vendet e tij fqinje. Financimi i specialistëve për instalimin e pajisjeve ose të tilla mund të merret përsipër dhe duhet të paraqitet më vete në preventivin e projektit. Financime personale të përfaqësuesit të projektin (paga ose honorare) ose të personit të besuar që zgjidhet nga Ambasada ashtu si dhe kostot e administratës dhe udhëtimeve **nuk mbështeten**,
- nuk sjellin detyrime të përsëritshme (p.sh. nevojën e vazhdueshme për mall konsumi si ushqime, ilaçe, materiale etj). Në kuadër të një financimi me faza mbështeten vetëm paraprodukte dhe materiale konsumi për një periudhë 6-mujore,
- mbyllen brënda vitit kalendarik në të cilin është nënshkruar edhe kontrata e subvencionit.

### **Nuk merren parasysh kërkes-projekte të cilët**

- u shërbejnë personave të veçantë ose grupeve tashmë të privileguara,
- klasifikohen si ndihma humanitare në raste katastrofe, krize ose ndihmë për ushqime,



- nuk parashikojnë mbulimin e shpenzimeve të mëtejshme nga përfaqësuesi i projektit ose projekte me zgjatje efektshmerie për më pak se 2 vjet,
- mbështeten nga programe të tjera të Republikës Federale të Gjermanisë (p.sh. Mbështetja e gjuhës gjermane, ruajtja e trashëgimisë kulturore),
- mbështesin zyra ose institucione shtetërore pa sjellë një përmirësim të mjaftueshëm të kushteve të jetesës së popullsisë lokale,
- lidhen me sektorin policor ose ushtarak.

### **Shëmbuj:**

- Infrastrukturë (rrugë, furnizimi me ujë të pishëm dhe energji elektrike, objekte komunale)
- Përmirësim i të ardhurave dhe i ushqimit (bujqësi) dhe mbrojtje mjedisi
- Shëndetësi dhe pajisje sanitare
- Sektori i arsimit shkollor dhe profesional
- Furnizimi me pajisje të përgjithshme

### **Shëmbuj për projekte që nuk merren në konsideratë:**

- Dhënie hua, pagesë kredie
- Blerje e një trualli
- Pajisje si laptop/fotokopje etj. për Ministri ose institucione shtetërore
- Broshura informative për turistë
- Blerje automjeti pa garanci për financimin e kostove të më vonshme dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit

### **Si të veproni:**

Kërkes-projekti duhet të dorëzohet tek Ambasada Gjermane dhe të përmbajë të dhënat e mëposhtëme:

- Përfaqësuesit e projektit
- Qëllimi i projektit
- Përfituesit
- Kohëzgjatja e projektit (e kufizuar në vitin kalendarik përkatës)
- Masat e parashikuara dhe dobia e tyre për përfituesit
- Financimi i projektit (duke përfshirë të dhënat mbi kontributin e kontraktuesit, kontributi i të tretëve dhe mbi mbështetjen e kërkuar nga Ambasada)
- 2 preventiv (oferta për materialet dhe koston e punës për zbatimin e projektit)



Ambasada  
e Republikës Federale të Gjermanisë  
Tiranë

Kërkes-projekti do të përpunohet nga Ambasada. Pas shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës mbyllet një kontratë subvencioni me përfaqësuesin lokal të projektit.

Për informacione të mëtejshme mund të kontaktoni Sektorin e Ekonomisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik pranë Ambasadës Gjermane në Tiranë.

**Adresa:**

Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë  
Sektori i Ekonomisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik  
Person kontakti: Znj. Merita Kurti  
Rruga Skënderbej, Nr. 8  
Tiranë  
Tel.: +355 (0) 4 2274 505  
Fax.: +355 (0) 4 2232 050  
E-Mail: [wi-100@tira.diplo.de](mailto:wi-100@tira.diplo.de)  
[www.tirana.diplo.de](http://www.tirana.diplo.de)

(Përditësuar më shkurt 2014)